



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 1239

NR. VENDIMI 2846

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
TIRANË

Nr. 15062/4322/1239 Regjistri Themeltar

Nr. 2846 Vendimi

Datë regjistrimi 26.11.2018

Datë 21.07.2020 Vendimi

VENDIM

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përberë nga

Gjyqtar Kryesues: Julian HAXHIU  
Gjyqtare Anëtare: Marjana DEDI SHEGANI  
Gjyqtare Anëtare: Teuta HOXHA

Asistuar nga sekretari gjyqësor Marin Bushati, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, sot më datën 21.07.2020 përfundoi shqyrtimin gjyqësor të çështjes civile me Nr. 1239 Regjistri Themeltar që i përket:

**PADITËS:** Shoqëria \*\*\*, me seli ne \*\*\*, NUIS \*\*\*përfaqësuar ne gjykim nepermjet prokures se pergjithshme nr. \*\*\*date \*\*\* te lëshuar ndaj \*\*\*\* NUIS \*\*\*, përfaqësuar nga Av. \*\*\* dhe/ose Av. \*\*\*, me seli ne \*\*\*

**NDËRHYRËS KRYESOR:** Shoqëria \*\*\*\* përfaqësuar nga avokati \*\*\*

**PALE E PADITUR:** Shoqëria \*\*\* me seli ne \*\*\*, me NUIS \*\*\* perfaqesuar nga avokati \*\*\*.

**OBJEKTI:** Ndalimi pa afat kohor te çdo lloji matje te pa kerkuar apo autorizuar nga \*\*\* ndaj \*\*\*, dhe mospërdorimin, mos citimin e emrit apo programeve te \*\*\* në matje të mëparshme të kryera, mos kalimin e këtyre të dhënave te subjekte të tjerë dhe në çdo rast mos përfshirjen në matje (të paautorizuar më parë nga \*\*\*) të tjera që \*\*\* mund të kryejë në tregun përkatës.

Shbërblim dëmi ndaj palës paditëse \*\*\*në shumën \*\*\*Euro

Publikimin e vendimit, me shpenzimet e pales se Paditur, në faqen zyrtare ëeb të Gjykates dhe në dy gazeta me shpërndarjen më të gjerë në treg.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 156, 187 të Ligjit nr. 9947 datë 7.7.2008 “Për Pronësinë

Industriale, Nenet 8, 9, dhe 44 te Ligjit nr. 9121 date 28.07.2003 “Per Mbrojtjen e Konkurences”; Nenet 617, 635 dhe 639 te Kodit Civil; Nenet 31, 202, 206, 310 dhe 317 e vijues te K. Pr. Civile.

Gjykata konstatoi se ceshtja është në juridiksionin gjyqësor dhe në kompetencë të kësaj gjykate, degjoi konkluzionet përfundimtare të palëve, të cilat kërkuan:

Pala paditëse kërkoj pranimin e padisë,  
Ndërhyrësi kryesor kërkoj pranimin e padisë,  
Pala e paditur kërkoj rrëzimin e padisë,

dhe, pasi shqyrtoi provat dhe e bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN:.**

Se pala paditëse i është drejtuar gjykatës me padi gjyqsore duke kërkuar ndalimin pa afat kohor te çdo lloji matje te pa kerkuar apo autorizuar nga \*\*\* Sh.p.k. ndaj \*\*\* Sh.a., mospërdorimin, mos citimin e emrit apo programeve te \*\*\* në matje të mëparshme të kryera, mos kalimin e këtyre të dhënave te subjekte të tjerë dhe në çdo rast mos përfshirjen në matje (të paautorizuar më parë nga \*\*\*) të tjera që \*\*\* mund të kryejë në tregun përkatës.

Pala paditëse ka pretenduar se \*\*\* Sh.a. një shoqëri aksionare, e regjistruar me Vendim të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë nr. \*\*\* datë \*\*\*, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS) \*\*\*, me zyra qendrore në adresën \*\*\*, me veprimtari në fushën e mediave audio-vizive, prodhim, transmetim dhe ritransmetim te programeve televizive, informacioneve, etj. Ky televizion është i licencuar rregullisht nga Autoriteti i Mediave Audio-vizive (në vijim referuar si “AMA”) sipas Licencës televizive. Sipas palës paditëse deri në ditën e depozitimit të kësaj ankese rezulton që \*\*\* të ketë një numër të larte të punësuarish në numër \*\*\*. \*\*\* është subjekt tatimpagues VIP sipas Vërtetimit nga Drejtoria Tatimore, Dega VIP. \*\*\* transmeton në territorin e Republikës së Shqipërisë me një cilësi shumë të lartë HD dhe pa ndërprerje 24/24 ore ne 365 ditë të vitit.

Pala paditëse ka pretenduar se matja e audiencës televizive në Shqipëri nuk është e rregulluar ligjërisht me një ligj të veçantë apo as edhe me parashikime në ligjin e AMA-s që mbikëqyr mediat televizive në vend. Kjo hapësirë e parregulluar nga ligji është duke u zënë në mënyrë progresive nga subjekte tregtare të cilët veprojnë mbi baza aspak të qarta dhe me matje audience televizive sipas elementëve matës të pa certifikuar nga asnjë Autoritet publik në Republikën e Shqipërisë. Në faqen ëeb të \*\*\* shihet qartë se një pjesë e mirë e klientëve të saj janë vetë Televizionet që në një farë mënyre duhet të masë vetë \*\*\* duke mos dhënë asnjë garanci për televizionet e tjerë apo edhe për vetë publikun. Këto matje kryhen në kushtet e disa shkeljeve që në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë edhe në jetën e televizionit \*\*\* duke u bërë përherë objekt i matjeve të pa certifikuar dhe të kontestuar nga televizioni

Sipas palës paditëse shoqëria \*\*\* duke funksionuar në kushtet e një tregu të pa rregulluar është njëkohësisht, në kushte monopoli të pastër duke qenë se kontrollojnë prej vitesh këtë treg dhe ka kontakte nga të cilat rrjedhimisht kërkon t’ju shesë këto matje “shërbime”. Por asnjëherë këto matje audience nuk janë certifikuar nga një

**Autoritet Publik duke pasjellë edhe që vetë televizionet nuk ju besojnë këtyre të dhënave dhe shpesh janë bërë edhe objekt diskutimi në AMA me grupet e interesit**

**Pala paditëse ka kërkuar marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar matjet e audiencës televizive nga pala e paditur shoqëria \*\*\* Sh.p.k. ndaj \*\*\* Sh.a., përgjatë të gjithë periudhës së shqyrtimit të kësaj padie gjyqësore. Pala paditëse ka pretenduar se kjo masë e përkohshme kërkohet mbi bazën e urgjencës dhe të rëndësisë që ka ky fenomen, i cili prek interesat ekonomike që mund të paragjykoen akoma edhe më shumë dhe te cenohen të drejtat e fituara nga \*\*\* nëpërmjet Licencës që disponon rregullisht nga AMA. Sipas palës paditëse abuzimi me pozicionin dominant të \*\*\* në këtë treg është i dukshëm dhe një vijim i këtij aktiviteti do të përkeqësonte situatën e \*\*\*, si nga ana ekonomike, si nga ana e imazhit. Ne te njejten linje edhe mbi parashikimet e Ligjit nr. 9947/2008 qe mbron te drejten e pronarit te markes te ndaloje menjehere perdorimin e markes apo emrit nga persona te trete (aq me teper qe nga ky perdorim paragjykohet mbarevajtja edhe ne fushen e Konkurences ne tregun e mediave.**

**Me anë të Vendimit datë 11.12.2018 Gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë ka vendosur sigurimin e padisë duke pezulluar matjet e audiencës televizive nga pala e paditur shoqëria \*\*\* Sh.p.k. ndaj \*\*\* Sh.a., përgjatë të gjithë periudhës së shqyrtimit të kësaj padie gjyqësore. Ndaj këtij vendimi gjyqësor Gjykata e Apelit ka vendosur mos pranim ankimi.**

**Pala e paditur ka pretenduar se veprimtaria tregtare e shoqërisë \*\*\* është një aktivitet i ligjshëm tregtar. Kjo shoqëri tregtare është regjistruar sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe paguan të gjitha detyrimet e saj tatimore dhe monetare pranë institucioneve përkatëse shtetërore. Objekti i saj kryesor tregtar për matjen e audiencës televizive është një aktivitet që nuk është i ndaluar në asnjë dispozitë ligjore në Republikën e Shqipërisë. Ky aktivitet është një aktivitet i ligjshëm i cili kryhet duke respektuar të gjitha aktet normative në lidhje me faturimet dhe detyrimet përkatëse. Pretendimet e palës paditëse në lidhje me përdorimin e Markës Tregtare është një pretendim i pambështetur në prova dhe në ligj. Pala e paditur nuk ushtron aktivitet të njëjtë me palën paditëse dhe nuk ka përdorur në asnjë rast markën tregtare të palës paditëse.**

**Sipas palës së paditur, pala paditëse ka pretenduar se pala e paditur i ka shkaktuar një dëm material në lidhje me matjet e paligjshme të audiencës televizive dhe për këtë arsye ka kërkuar shpërblym dëmi. Ky është një pretendim tërësisht i pambështetur në ligj. Një nga parimet e dëmit jashtëkontraktor është veprimi i paligjshëm i kryer dhe pasoja përkatëse. Nga i gjithë hetimit gjyqësor ka rezultuar se aktiviteti i palës së paditur është një aktivitet i ligjshëm dhe nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore. Duke qenë se aktiviteti i palës së paditur është një aktivitet i ligjshëm në përputhje me legjislacionin shqiptar, atëherë nuk plotësohet kushti për ekzistencën e dëmit jashtëkontraktor të shkaktuar ndaj palës paditëse.**

**Neni 44 i Kushtetutës, parashikon se:**

**“Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.**

**Ne nenin 608 e Kodit Civil per përgjegjësinë e shkakimit të dëmit parashikohet se**

**Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkakuar.**

**Personi që ka shkakuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj. Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cënimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira.**

**Gjatë hetimit gjyqësor në lidhje me këtë padi gjyqësore gjykaka ka administruar provat shkresore të depozituara nga palët si dhe mbi kërkesë e paditësit është lejuar marrja e si provë e ekspertimit gjyqësor.**

**Nga Ekstrakti Historik i Regjistrimit Tregtar lëshuar nga QKB rezulton se \*\*\* Sh.a. një shoqëri aksionare, e regjistruar me Vendim të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë nr. \*\*\* datë \*\*\*, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS) \*\*\*, me zyra qendrore në adresën \*\*\*, me veprimtari në fushën e mediave audio-vizive, prodhim, transmetim dhe ritransmetim të programeve televizive, informacioneve, etj.**

**Me anë të Licensës lëshuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizuale rezulton se pala paditëse është licencuar nga Autoriteti i Mediave Audio-vizive me licensë për transmetim televiziv kombëtar.**

**Nga Urdhërpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore për muajt nga janar në shtator 2018 rezulton që \*\*\* të ketë një numër të lartë të punësuarish në numër \*\*\* punonjësish.**

**Nga Pasqyrat financiare të konsoliduara më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2017 të \*\*\* dhe nga Vërtetimi nga Drejtoria Tatimore, Dega VIP rezulton se është subjekt tatimpagues VIP regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.**

**Në të drejtën tonë procedurale është e njohur e drejta e ndryshimit të shkakut ose objektit të padisë ose edhe të dy elementeve në çdo fazë të gjykimit (neni 185 i K. Pr. Civile). Kjo arsyetohet me faktin se paditësi gjatë gjykimit ka të drejtë të ndreqë gabimet e të korrigjojë pasaktësitë e padisë me qëllim që t'u përshtatet, marrëdhënieve juridike të palëve ndërgjyqëse. Neni 185 i K.Pr.Civile parashikon formulimin se “Paditësi gjatë hetimit gjyqësor, ka të drejtë të ndryshojë shkakun ligjor të padisë. Ai pa e ndryshuar shkakun ligjor të saj, mund të shtojë, të pakesojë, ose ndryshojë objektin e padisë”. Kjo dispozitë interpretohet në mënyrë që mund të ndryshohen edhe të dy elementet e padisë. Pra shkakun mund të ndryshohet në çdo kohë, e drejtë kjo absolute e paditësit. Por paditësi pa e ndryshuar shkakun mund të ndryshojë objektin e padisë. Në interpretim gjuhësor të të dy fjalive të dispozitës rezulton se objekti i padisë mund të ndryshohet pavarësisht nga shkakun, d.m.th. në mënyrë të pavarur, mund të ndryshohet objektin duke mbajtur të njëjtin shkak. Ndërsa shkakun në interpretim direkt të dispozitës mund të ndryshohet në çdo kohë duke mbajtur të njëjtin objekt. Fakti se po u ndryshuan të dy elementet mund të kemi një padi të re nuk sjell ndonjë problem të madh sepse kjo është e drejtë e paditësit. Në bazë të parimit të**

disponibilitetit kufizimi kësaj te drejte do te sillte cenim të këtij parimi. Edhe ndërgjyqësia mund të ndryshohet pa kufizim me anë të zevëndësimit të palëve. Po kështu edhe shkakun me objektin e padisë.

Në këndvështrim të dispozitës së mësipërme jurisprudenca gjyqësore duke pranuar parimin e disponibilitetit të paditësit në lidhje mbi padinë, i ka dhënë një rol aktiv edhe gjykatës në lidhje me përcaktimin e shkakut ligjor të padisë. Në Vendimin Unifikues Nr. 2, datë 29.03.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë është arsyetuar:

..... “gjykata e zbulon shkakun e padisë së paditësit duke e analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar tek dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj. Mund të ndodhë që paditësi të referojë gabimisht dispozitat ligjore, porse nga leximi i kërkesëpadisë del e qartë e drejta që ai kërkon të mbrojë. Në këtë rast gjykata duhet të zgjidhë çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar. ...

Pra konform këtij vendimi unifikues dhe detyruet për gjykatën, pavarësisht se çfarë rezulton në padinë e ndodhur në dosjen gjyqësore nga hetimi gjyqësor del e qartë se paditësi dhe ndërhyrësi kryesor kërkojnë ndalimin e aktivitetit të palës së paditur në lidhje me shoqëritë e tyre tregtare dhe pala paditëse kërkon shpërblimin e dëmit material që i ka ardhur nga veprimet e paligjshme të palës së paditur.

Fillimisht gjykata vlerëson se duhet të sqarojë ligjshmërinë e aktivitetit të palës së paditur. Pala paditëse dhe ndërhyrësi kryesor kanë pretenduar se pala e paditur ushtron një aktivitet të paligjshëm duke matur audiencën televizive të tyre pa pasur asnjë marrëveshje midis tyre. Duke qenë se ato kanë pretenduar paligjshmërinë e aktivitetit të palës së paditur është detyrimi i këtyre subjekteve ndërgjyqëse që të provojnë këto pretendime. Barra e provës ose barra e të provuarit (onus probandi) është përcaktimi i subjektit (palës) në procesin gjyqësor civil që duhet të provojë faktin (faktet) e pretenduar. Në nenin 12 të K.Pr. Civile jepet një përkufizim i ngjashëm me këtë: “Pala që pretendon një të drejtë, ka detyrimin që në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilat bazon pretendimin e saj “. Është detyrë e palëve në process për të paraqitur pretendimet lidhur me faktet në të cilat i mbështesin kërkimet e tyre, si dhe provat me të cilat mund të vërtetohen këto pretendime. Ky rregull zbatohet si për kërkesë padinë e paditësit ashtu edhe për prapësimet e të paditurit. Eshte e njohur shprehja: kush ngre pretendimin duhet ta provoje atë. Pikërisht këto detyrime të palëve në teori janë quajtur barra e provës.

Në procesin gjyqësor civil rregullat për ndarjen barrës së provës e zgjidhin çështjen se cila palë do të humbas gjyqin kur një fakt mbetet i pa provuar. Rregulli i përgjithshëm eshte se secila palë e ka barrën e provës për ato fakte të cilat i vijnë asaj në ndihmë. Kjo do të thotë se pala që pretendon ekzistencën e një të drejte, e ka barrën e provës së atyre fakteve që parashikon e drejta materiale si prezumim i ekzistencës së saj dhe e kundërta, pala që mohon ekzistencën e një të drejte ka barrën e provës së fakteve që pengojnë ekzistencën e saj ose se ajo është shuar.

Ndryshe nga legjislacioni i mëparshëm procedural, sipas Kodit të Procedurës Civile provat tregohen vetëm nga palët. Gjykata nuk është e autorizuar të marrë prova kryesisht (ex officio), nuk ka rol aktiv, dhe sidomos në procesin e të provuarit gjykata

asesi nuk mund të nderhyje në marrjen apo paraqitjen e provave. Pra barra e provës është detyrë ekskluzive e palëve. Por kjo nuk do të thotë se gjykata nuk duhet të nderhyje në procesin e te provuarit. Gjykata provat e paraqitura nga palët i pranon ose refuzon me vendim. Ajo ruan të drejtën të përcaktojë rrethin e atyre fakteve që e përbëjnë objektin e provës, duke e realizuar këtë me përcaktimin me vendim se cilat prova lejon të merren si të rëndësishme për çështjen në gjykim. Kur një provë të paraqitur nga njëra ose tjetra palë gjykata e cmon se nuk ka lidhje me çështjen, ajo ka të drejtë të mos e pranojë atë. Ky qëndrim gjen mbështetje në nenin 213 të K.Pr.Civile. Në këtë dispozitë thuhet: “në zbatim të nenit 12 të këtij Kodi, gjykata me vendim lejon palët të provojnë faktet mbi të cilat i bazojnë kërkimet dhe pretendimet e tyre, duke paraqitur në gjykatë vetëm ato prova që janë të domosdoshme e që kanë lidhje me çështjen e gjykimit”. Pra, kur gjykata një provë të paraqitur e quan të parëndësishme për çështjen, ajo me vendim refuzon marrjen e saj.

Në teorinë procedurale civile mbisundon mendimi se rregullat e barrës së provës janë në radhë të parë të karakterit materialo-juridike, për arsye se përcaktohen nga dispozitat materialo-juridike. Nga dispozitat materiale ku mbështetet kërkitimi i padisë i del se cilës palë i bie barra e të provuarit. Në varësi të padisë, paditësi duhet të provojë pasojat juridike dhe pasurore që i kanë ardhur nga veprimet e paligjshme të palës së paditur.

Në praktikë jo gjithmone është e lehtë të dallohet se cilës palë i bie barra e të provuarit të një fakti të caktuar, sidomos atëherë kur në dispozitat ligjore materiale nuk është e shprehur, si në shembujt e mësipërm. Për të dalluar se cili nga ndërgjyqësit duhet të provojë një fakt, d.m.th. se cilit i bie barra e provës, ndihmon shumë ndarja e fakteve në fakte formues, pengues dhe shues.

Në rastin konkret pala paditëse ka pretenduar se pala e paditur ka kryer veprime të paligjshme dhe si pasojë e këtyre veprimeve palës paditëse i kanë ardhur dëme të ndryshme financiare. Sa më sipër është detyrimi i palës paditëse të provojë pretendimet e saj gjyqësore duke i mbështetur në prova dhe në ligj.

Sistemi i matjes së audiencës televizive, ose përndryshe, sistemi i të dhënave TAM (anglisht: Television Audience Measurement, shqip: Matja e Audiencës Televizive), është një degë e specializuar e fushës së studimit të tregut të medieve, që ka për qëllim vlerësimin sasior (kuantifikimin) dhe cilësor të informacionit të hollësishëm mbi shikueshmërinë e programeve televizive dhe ndërprerjeve publicitare në rrjedhën e programacionit të TV-ve. Shërbimi TAM është një mjet kyç për organizimin dhe menaxhimin e të gjitha fushave të veprimtarisë së industrisë së reklamës në përgjithësi, dhe atë të transmetimeve televizive në veçanti. Për këtë arsye cilësia e këtyre të dhënave, është parametri më i rëndësishëm për vlerësimin dhe matjen e audiencës.

Nga hetimi gjyqësor ka rezultuar se aktiviteti i palës së paditur në sistemin e matjes së audiencës televizive nuk rregullohet në mënyrë specifike me ligj dhe as me akte normative. Por, gjatë hetimit gjyqësor nuk është provuar në asnjë moment që aktiviteti i palës së paditur bie në kundërshtim me dispozitat ligjore. Duke qenë në këto kushte për gjykatën nuk ka asnjë pengesë procedurale që të zhvillojë hetim gjyqësor ndonëse është një aktivitet i parregulluar në mënyrë specifike me akte normative. Edhe në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile është garantuar ushtrimi i pushtetit gjyqësor nga gjykatat në mënyrë të pavarur. Në nenin 28 ndër të tjera thuhet se gjykata duhet

të realizojë një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm. Sipas nenit 1 paragrafi i dytë I KPRC, gjykata është e detyruar të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështje që i paraqiten për shqyrtim edhe kur mungon ligji, ose nuk është i plotë, është i paqartë apo ka kundërthënie.

Ndonëse në Ligjin Nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” nuk është parashikuar specifikisht çështja e matjes së shikueshmërisë televizive, gjykata shpreh opinionin e saj ligjor që AMA përmes dispozitave ligjore të këtij ligji mund dhe duhet të gjejë një rregullim normativ në lidhje me matjen e audiencës. Në dispozitat ligjore të këtij ligji ka hapësira ligjore me anë të cilave AMA mund të ndërmarrë një rol më aktiv në lidhje me këtë aspekt të rëndësishëm televiziv. Gjykata merr në konsideratë faktin që kjo çështje është delikate pasi përfshin interesa të ndryshme legjitime të subjekteve televizive si dhe të subjekteve reklamuese. Por në cdo rast nuk kemi të bëjmë me njw veprimtari të jashtëligjshme. Në cdo rast AMA duhet të gjejë mundësi rregulluese apo lobuese në lidhje me këtë çështje pasi në tërësinë e saj është një që duhet të gjejë rregullim të plotë në përputhje dhe me aktet ndërkombëtare.

Roli i AMA si pjesëmarrëse e paanshme mund të përbëjë stimulin që do të mbështeste ngritjen e një sistemi të financuar, të dakordësuar dhe të pranuar gjerësisht të matjes së audiencave televizive në Shqipëri që do të sillte edhe pjesëmarrjen e transmetuesve. Në një sërë tregjesh, është stafi i komisioneve të përbashkëta të industrisë ai që koordinon marrëdhënien mes aksionerëve/agjentëve sigurues dhe organizatave të studimit të tregut dhe që administron shërbimin dhe ekzistenca e tij vepron si një mbështetje e mëtejshme e besimit. AMA mund të luajë një rol cilësor e gjerësisht të pranuar të matjes së audiencave televizive si një sistem që do të zëvendësonte situatën aktuale dhe përfitimin që ai do t'i sillte gjithë industrisë së televizionit dhe tregut të kohës televizive si diçka që ajo duhet ta mbështesë aktivisht duke marrë pjesë vetë në të. Matja e audiencës nuk duhet kuptuar si një aktivitet i lidhur vetëm me shikueshmërinë e televizionit përkatës por duhet trajtohet si një mekanizëm i rëndësishëm tregu, i cili përfshin reklamën tregtare si një shtyllë e funksionimit dhe rritjes së shoqërive tregtare. Reklama është një formë komunikimi e marketingut me qëllim që të bindë audiencën të ndjekë në raste më të shpeshta shitjen e një ose disa produkteve të caktuara.

Në nenin 6 të Ligjit Nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se AMA është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në nenin 19 të Ligjit Nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se AMA kontrollon zbatimin e këtij ligji nga subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën objekt të këtij ligji dhe, në rast shkeljesh, vendos sanksione. Garantimi i konkurrencës së ndershme, duke siguruar njëkohësisht zhvillimin e mëtejshëm të RTSH-së.

Në nenin 29 i Ligjit Nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se

Vlerësimi i efekteve në tregun e transmetimeve

1. AMA vlerëson rezultatet e zhvillimit në fushën e transmetimeve audio dhe/ose

audiovizive dhe shqyrton masën në të cilën zhvillimi i transmetimeve prek: a) cilësinë, shkallën e mbulimit me shërbime dhe llojet e tyre, si dhe mundësinë e zgjedhjes së shërbimeve nga shikuesit dhe dëgjuesit; b) shpërndarjen e shërbimeve në fushën e transmetimeve; c) efektet e zhvillimeve teknologjike, risive dhe investimeve në këtë fushë; ç) tregjet e lidhura me transmetimet; d) çështje të tjera që AMA i vlerëson të arsyeshme për këtë qëllim.

2. AMA analizon periodikisht efektet e ndryshme në tregun e transmetimeve, me qëllim ushtrimin sa më të përshtatshëm të funksioneve të veta rregullatore. Për këtë qëllim AMA mund të bashkëpunojë me institucionet përkatëse publike dhe me ofruesit e shërbimeve mediatike.

Gjykata vëren se për transmetuesit audiot televiziv matja e audiencës ofron informacion që u tregon se si po ecin, si po u shërbejnë audiencave publike dhe si mund të përmirësohen programet që ata zgjedhin, oraret e tyre dhe promovimi. Për subjektet tregtare që shesin reklama, matja e audiencës u krijon panoramën e saktë e nivelit të shikueshmërisë potenciale të reklamës së tyre në televizionin përkatës. Për ato televizione që varen nga financa publike, informacioni që jep matja e audiencës mund të tregojë se si po i shërbejnë publikut që i financon për ta garantuar atë burim financimi. Pa të dhëna të besueshme të matjes së audiencës, transmetuesit televiziv mund të marrin në rastin më të mirë vetëm një pjesë të gjithë kësaj përmes kryerjes së sondazheve të veta periodike. Për reklamuesit dhe agjencitë e reklamave, matja e audiencës ofron raportin e drejtë midis reklamës dhe cmimit të saj. Ata mund t'i përdorin të dhënat për të planifikuar, për të blerë dhe për të vlerësuar fushatat e reklamimit. Pa të dhëna të besueshme të matjes së audiencës reklamuesit jo vetëm që nuk do të kenë informacionin që u tregon se çfarë mund të blejnë, por ata nuk do të dinë as më pas se çfarë kanë blerë. Për një rregullator, të dhënat e matjes së audiencës mund të tregojnë se si respektohet licenca dhe nëse të licencuarit u përmbahen termave të licencës apo jo. Pa të dhëna të besueshme të matjes së audiencës, ky informacion mund të merret në rastin më të mirë pjesërisht përmes sondazheve periodike.

Televizioni dhe veçanërisht reklamat në televizion kanë qenë gjithmonë një lloj biznesi i pazakontë sa i përket matjes së performancës së tyre. Shumica e industrive të tjera e masin aktivitetin e tyre brenda për brenda atij aktiviteti duke angazhuar shoqata apo shoqëri për mbikqyrje tregu. Televizioni në formën e tij tradicionale – transmetim përmes ekraneve televizive – nuk mund ta bëjë këtë gjë, kështu që është mbështetur zakonisht tek burime të jashtme të matjes së audiencës. Këtej rrjedhin edhe sistemet e matjes së audiencës televizive të cilat përdorin në mënyrë konvencionale një kampion përfaqësues të një paneli matjeje. Kështu, pavarësisht se sa mirë apo keq bëhet matja, kjo mbetet e kufizuar, duke qenë produkt i studimit të tregut. Në këtë kontekst, besimi është shumë i rëndësishëm për sistemet matjet e audiencës që ato të pranohen dhe të përdoren gjerësisht.

Baza statistikore e matjes së audiencës si shembull i kampionimit të studimit të tregut duhet të jetë e qartë. Ekziston një pikëpamje se konkurrenca mund të jetë po aq përfituese për shërbimet e matjes së audiencës televizive, sa edhe për mallra dhe shërbime të tjera. Shërbimet e matjes së audiencës dhe rankimet që ato prodhojnë nuk janë opinione, por fakte statistikore. Si rregull, në tregjet ku ka një sistem të pranuar cilësor të matjes së audiencës televizive, reklamuesit nuk mund ta dinë me siguri paraprakisht se çfarë janë duke blerë, duke qenë se kjo shihet në të ardhmen, por ata e



dinë se çfarë kanë blerë pas fushatës së reklamave. Për reklamuesit dhe agjencitë e reklamave në Shqipëri, situata aktuale do të thotë se ata nuk e dinë as më pas se çfarë kanë blerë.

Kjo është pikërisht arsyeja se përse në disa tregje ndërkombëtare matja e audiencës televizive kryhet shpesh nga Komisione të Përbashkëta të një aktiviteti apo një Industrie të transmetuesve, agjencive të reklamave dhe reklamuesve ose ndonjëherë nga një Komision i Pronarëve të Medias ose thjesht nga transmetuesit. Kryerja në mënyrë të përbashkët e matjeve, zakonisht nga një organizatë e pavarur e studimit të tregut dhe ndonjëherë përmes menaxhimit të kontratës nga një organ i pavarur i përbashkët me një organizatë të studimit të tregut mund të funksionojnë mjaft mirë për të krijuar besim tek të dhënat e prodhuara, sepse me këtë lloj transparence është shumë më e vështirë për një të tjetër palë që ta korrtojë procesin dhe që kjo gjë të mos diktohet dhe se e gjitha kjo mund të jetë një përpjekje e përbashkët për ta bërë sistemin sa më të mirë. Pretendimi dhe analogjia me sondazhet e partive politike nuk gjen aspak hapësirë në cështjen object gjykimi pasi partitë politike janë subjekte juridike të bazuara në vullnetin e anëtareve dhe jo për qëllime kryesisht tregtare. Sondazhi është një metodë statistikore me anë të të cilës vlerësohen dhe gjykohen proporcionet e karakteristikave të ndryshme të një popullate, duke u nisur nga studimi i një pjese të popullatës e quajtur mostër (kampion). Proporcionet përcaktohen me disa skaje gabimi, që janë subjekte të studimeve të mëtejshme të kujdesshme për të përcatuar vlefshmërinë, të vetë sondazhit. Ndërsa shoqëritë tregtare janë persona juridik që në themel të krijimi dhe ekzistencë së tyre kanë qëllime fitimi dhe cdo veprim që cënon këtë aktivitet krijon premise cënimi tregtar. Çdo matje apo sondazh ndaj këtyre subjekteve tregtare duhet të mos cënojë të drejtat pasurore dhe jo pasurore të tyre. Për të siguruar adoptimin dhe përdorimin e të dhënave të matjes së shikueshmërisë televizive nga të gjitha palët e interesuara, sistemi i matjes së audiencës televizive duhet të jetë:

i besueshëm, ku, çdo element i procesit të mbledhjes, analizës dhe publikimit të këtyre lloj të dhënave të mund të verifikohet nëpërmjet sistemeve të paracaktuara kompjuterike, apo metodave të tjera;

b. transparent, ku, çdo element i sistemit është lehtësisht i kuptueshëm dhe i hapur, apo i arritshëm, nga auditimi i kualifikuar i të gjithë lojtarëve të interesuar për këto lloj të dhënash në treg.

c. i pavarur, atëherë, kur ofruesi i këtij shërbimi operon nga një pozicion tërësisht neutral, apo krejtësisht i paanshëm, dhe i gjithë-pranuar nga të gjithë lojtarët në treg;

Sic rezulton nga literatura përkatëse, konsumatori më tipik për produktet/shërbimet e të dhënave të shikueshmërisë dhe renditjen përkatëse janë:

agjencitë e reklamës dhe agjencitë e shërbimeve të media planning, scheduling dhe/ose buying,

rrjetet dhe kanalet televizive,

(c) kompanitë e biznesit/organizatat institucionet publike vendore dhe/ose ndërkombëtare që blejnë reklamë në TV Të gjithë këta aktorë ndjejnë nevojën për një sistem të mbledhjes dhe analizës së të dhënave rating dhe matjes së audiencës së TV-ve.

Shërbimi i matjes së audiencës bën të mundur që këta aktorë të përmirësojnë performancën marketing të biznesit të tyre, dhe rrjedhimisht, fitimet që vijnë si pasojë e rritjes së nivelit të shitjeve apo njohjes së markës nga konsumatori si rezultat i investimeve përkatëse marketing. Por nga ana tjetër, ky shërbim u drejtohet dhe institucioneve të tjera shtetërore, dhe atyre të pavarura, të kërkimit dhe akademike, që kanë një interes të veçantë për të kuptuar dhe studiuar tregun e medias. Informacioni i të dhënave të audiencës që sigurohen nga shërbimi i matjes së shikueshmërisë televizive, iu adresohet nga përdoruesve të këtyre të dhënave për të blerë dhe shitur kohën televizive, si edhe për të marrë vendime rreth programacionit të televizioneve, duke u shndërruar kështu në ‘monedhën e përbashkët’ të transaksioneve ndërmjet blerësve dhe shitësve të kohës publicitare në TV.

Nga e gjithë praktika kombëtare dhe ndërkombëtare rezulton se pa ekzistencën e një sistemi të pavarur matjeje, si palë e tretë, i cili, adopton standardet më të larta të saktësisë dhe integritetit, tregu i televizioneve nuk do të mund të funksiononte në mënyrë të efektshme. Për menaxhimin sa më të saktë, dhe sigurimin e transparencës maksimale, që ndihmojnë në sigurimin e besueshmërisë së shërbimit të matjes së audiencës TV, shoqëritë apo subjektet që kryejnë matje duhet që të marrin parasysh edhe zbatimin e rekomandimeve të “praktikave më të mira,” në lidhje me aktivitetin e matjes së audiencës së televizioneve edhe në vende të tjera që e kanë prej kohësh një shërbim të tillë sic janë Udhëzimet Globale për Matjen e Audiencës së Televizionit (Global Guidelines for Television Audience Measurement).

Sa më sipër gjykata arrin në konkluzion se matja e audiencës televizive si aktivitet tregtar është një aktivitet i ligjshëm i cili nuk ka lidhje vetëm me aktivitetin televiziv por edhe me reklamat si një nga shtyllat e organizimit dhe rritjes së aktivitetit tregtar.

Pretendimet e palës paditëse në lidhje me paligjshmërinë e aktivitetit të palës së paditur nuk janë të mbështetura në prova dhe në dispozita ligjore. Nga hetimi gjyqësor ka rezultuar se pala e paditur ushtron një aktivitet tregtar të ligjshëm, duke u regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe pranë organeve tatimore përkatëse. Objekti i aktivitetit të saj nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore apo akt normativ. Ky aktivitet ushtrohet mbi bazën e kontratave dhe faturave përkatëse të lidhura miis palës së paditur dhe subjekteve të tjera tregtare.

Në lidhje me procesin e matjes së shikueshmërisë dhe publikimin e matjeve të shikueshmërisë mbi palën paditëse, gjykata vëren se duhet bërë dallimi midis ligjshmërisë së aktivitetit të palës së paditur nga njëra anë dhe matjeve dhe publikimin e matjeve pa vullnetin e subjekteve përkatëse. Ndonëse matja e audiencës televizive është një aktivitet i ligjshëm, kryerja e matjeve dhe publikimi i matjeve në forma të ndryshme çënon të drejtat e subjekteve të tjera që nuk kanë kontrata shërbimi me palën e paditur. Në varësi të subjekteve të cilave u ofrohet shërbimi i matjes së audiencës televizive, pala e paditur nuk mund të kryejë matje dhe të publikojë rezultatet e audiencës për aq kohë sa nuk ka marrë pëlqimin më parë të të gjitha subjekteve televizive të përfshira në matjen përkatëse. Matja e audiencës duhet shoqërohet me kontrata të shërbimi, me anë të cilave pala e paditur duhet të marrë përsipër ruajtjen e konfidencialitetit tek të tretët (konkurentët televiziv).

Nga aktet shkresore rezulton se pala e paditur ndonëse ka kontrata shërbimi me disa

subjekte televizive, ajo ka bërë publike matjet e saj televizive jo vetëm për klientët saj televiziv por edhe për palën paditëse. Këto kontrata shërbimi kanë parashikuar objektin e aktivitetin të palës së paditur duke përfshirë në këtë object matjen e shikueshmërisë televizive për palën e interesuar por duke cituar në këto kontrata që matjet të bëhen ndër të tjera edhe për palën paditëse.

Konkretisht nga Marrëveshja datë 01.10.2018 lidhur midis shoqërisë ..... (transmetues televiziv) dhe shoqërisë \*\*\* sh.p.k është rënë dakord për kryerjen e shërbimit nga ana e shoqërisë \*\*\* sh.p.k për nxjerrjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave të shikueshmërisë televizive për periudhën 01.10.2018 – 31.09.2019 kundrejt një cmimi që porositësi i shërbimit do ti paguajë shoqërisë \*\*\* sh.p.k. Në pikën 3.3 të kësaj të kësaj marrëveshjeje është rënë dakord edhe për të dhënat e shikueshmërisë për palën paditëse \*\*\*, \*\*\*, .... Etj. Nga shqyrtimi i kësaj marrëveshjeje por edhe nga séanca gjyqësore ka rezultuar se pala paditëse shoqëria \*\*\* sh.a dhe ndërhyrësi kryesor shoqëria “\*\*\*” SHA nuk kanë dhënë asnjë formë pëlqimi për matjen përkatëse dhe publikimin e saj sipas objektit të kësaj marrëveshjeje.

Kryerja e matjes dhe publikimi i të dhënave për matjen e audiencës për subjektet jo kontraktorë me palën e paditur, do të cënonte këto subjekte në aktivitetin e tyre tregtar pasi ato do i nënshtroheshin një procesi të padrejtë vlerësimi tregtar, që do të ndikonte direkt në aktivitetin e tyre. Pala e paditur duhet të marrë masa që ky informacion për matjet e kryera të mbetet konfidencial dhe të mos përhapet nën përgjegjësinë e saj. Çdo subjekt tregtar ka të drejtë të porosisë një vlerësim tregu (market survey) në lidhje me aktivitetin e tij. Mirëpo ky process nuk mund të cënojë subjekte të tjera tregtare, për të cilat cdo reklamim apo publikim të rezultateve do të sillte një cënim të të drejtave pasurore dhe jo pasurore të këtyre subjekteve. Për Agjencitë Publicitare dhe Agjencitë e Specializuara të Blerjes së Kohës Publicitare në TV, të dhënat e matjes së shikueshmërisë përbëjnë informacionin themelor, mbi të cilin e bazojnë veprimtarinë e tyre, departamentet e shërbimit të medias brenda agjencive publicitare dhe agjencive të specializuara të blerjes së kohës publicitare, për:

a. hartimin e media-planeve për shpenzimin dhe shpërndarjen e buxheteve të klientëve të tyre për fushata të ndryshme publicitare në televizion.

b. përpunimin e raporteve e studimit të tregut të medias dhe atyre marketing.

c. kryerjen e analizave, të cilat mundësojnë vlerësimin e suksesit, apo mos-suksesit, të fushatave publicitare të propozuara dhe të ekzekutuara nga agjencitë publicitare për klientët e tyre të biznesit), dhe një sërë veprimtarish të tjera të këtyre operatorëve të biznesit.

Në këtë mënyrë Prezantimi renditjes së subjekteve audiot televizive për subjekte të pakontraktuara ndikon tek Agjencitë Publicitare dhe Agjencitë e Specializuara të Blerjes së Kohës Publicitare në TV për shpërndarjen e reklamave apo edhe për emrin tregtar. Këto janë ndikime direkte dhe in direkte në aktivitetin tregtar të tyre dhe për këtë arsye potencialisht cënojnë të drejtat e tyre. Për këtë arsye pala e paditur duhet të ndalojë matjen dhe publikimet e matjeve që kryen në faqen e saj të web (world wide web) dhe çdo publikim tjetër si dhe të marrë masat e saj që të ruhet konfidencialiteti i matjeve të kryera.

**Vendimi Nr.12 datë 13.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ka rregulluar të gjithë praktikën gjyqësore në lidhje me me shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor pasuror dhe jo pasuror. Ky vendim ka trajtuar në mënyrë tërësore të gjithë problematikën e dëmit pasuror dhe jo pasuror. Për këtë arsye gjykata është mbështetur kryesisht në orientimin që ka dhënë ky vendim unifikues në lidhje me konceptin e dëmit pasuror.**

**Neni 608 i këtij Kodi parashikon:**

**“Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.**

**Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj. Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cënimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira”.**

**Neni 609 i këtij Kodi parashikon:**

**“Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit. Mospengimi i një ngjarjeje nga personi që ka detyrimin ligjor për ta mënjanuar, e ngarkon atë me përgjegjësi për dëmin e shkaktuar”.**

**Nga analiza që i bëhet këtyre dispozitave ligjore rezulton se që të ekzistojë koncepti i shpërblimit të dëmit duhet që dëmi të jetë shkaktuar me faj, si rrjedhojë e një veprimi të paligjshëm dhe ky dëm ti drejtohet interesave pasurore të shtetasve apo ndaj subjekteve tregtare. Pra janë keto elemente ligjore që duhet të plotesohen në mënyrë që të ekzistojë dhe të ligjerohet dëmshpërblimi. Në zbatim të nenit 609 të Kodit Civil për pranimin e përgjegjësisë civile jashtëkontraktore, duhet të vërtetohet lidhja shkakësore materiale ndërmjet sjelljes (veprimit a mosveprimit) së paligjshme e me faj dhe dëmit të shkaktuar. Në vijim, për përcaktimin e dëmtimeve (cënimeve) konkrete që rrjedhin nga ky fakt i paligjshëm dhe caktimin e dëmshpërblimit përkates, duhet të vërtetohet edhe lidhja shkakësore juridike ndërmjet tyre.**

**Nëpërmjet lidhjes shkakësore materiale, vërtetohet se cili është personi përgjegjës (subjekti aktiv) dhe lidhja shkak-pasojë ndërmjet tre elementeve objektive e subjektive të faktit të paligjshëm (ngjarjes së dëmit): sjelljes së paligjshme (objektiv) e me faj (subjektiv) dhe pasojës së ardhur prej tyre, pra dëmtimit të një tjetri në personin a pasurinë e tij (objektiv). Në këtë rast zbatohet parimi juridik *condicio sine qua non*, sipas të cilit, ardhja e pasojës së dëmtimit nuk do të vërtetohet nëse nuk do të kishte ndodhur shkak, sjellja e paligjshme dhe me faj e personit përgjegjës për shkaktimin e dëmit.**

**Me lidhjen shkakësore juridike vërtetohet lidhja shkak-pasojë ndërmjet faktit të paligjshëm në tërësinë e tij dhe cënimeve konkrete të pësuar në të drejta dhe interesa të ligjshme, si të subjektit pasiv mbi të cilin ka vepruar direkt ky fakt i paligjshëm, ashtu edhe të personave të tjerë që rezultojnë të dëmtuar si rrjedhojë e pasojave që pranohet se vijnë normalisht e zakonisht nga i njëjti fakt të paligjshëm, sipas parimeve të rregullshmerisë dhe eficiencës së lidhjes shkakësore (*id quod plerumque accidit*).**

**Në këtë kuptim, lidhja shkakësore nuk ndërpritet nëse pas vërtetimit të faktit të paligjshëm dhe pasojës “natyrale”, “materiale”, të ardhur prej tij, pra dëmtimit të**

interesave të ligjshme të subjektit pasiv nga sjellja e shkaktuesit të dëmit, vijojnë e vërtetohen fakte të reja me pasoja të dëmshme, të cilat konsiderohen të lidhura e rrjedhojë direkte dhe e menjëhershme e të njëjtit fakt të paligjshëm, përderisa provohet që nese ky nuk ndodhte, fakti i ri, i mevonshem, ne vetvete, nuk mund te shkaktonte edhe ai te njejten pasoje te dëmshme.

Gjykata për të sqaruar dhe për të marrë një informacion më të plotë të specializuar në lidhje me pretendimet e palës paditëse për dëmin e shkaktuar nga pala e paditur, ka vendosur të kryejë një Akt Ekspertimi Kontabël. Nga Akti i Ekspertimit 14.10.2019 punuar nga eksperti \*\*\* rezulton se janë dhënë përgjigje teknike për të gjitha pyetjet dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse. Në lidhje me vlerën ekonomike që ka marka tregtare \*\*\* në vlerë tregu, eksperti ka sqaruar se marka si një aktiv afatgjatë jomaterial matet me kosto ose me vlerën e tregut nëqoftëse vlera e tij mund të matet me besueshmeri. Shoqëria nga ana e saj nuk ka matur ndonjë kosto për krijimin e markës së saj. Gjithashtu në mungesë të një tregu të mirëfilltë për vlerësimin e markës bëhet e vështirë matja e vlerës së tregut të markës rrjedhimisht nuk mund të përcaktohet me besueshmëri vlera ekonomike e markës tregtare \*\*\* me të dhënat që kemi në dispozicion.

Të dhënat për xhiron, kostot dhe fitimet e shoqërise \*\*\* për vitet 2016,2017 dhe 2018 pasqyrohen ne aktin e ekspertimit ne menyre tabelare.  
Po ashtu edhe të dhënat per xhiron, kostot dhe fitimet e shoqerise \*\*\* janw analizuar pwr vitet 2016,2017 dhe 2018 .

Nw aktin e ekspertimit nga analiza e bere treguesve ekonomiko financiare rezulton se :  
Duke krahasuar faturimet e vitit 2017 me ato të vitit 2016 per grup klientesh te analizuar kliente kemi nje renie te faturimeve ne shumen \*\*\* leke (tabela 3).  
Duke krahasuar faturimet e vitit 2018 me ato te vitit 2017 per keta kliente kemi nje renie te faturimeve ne shumen \*\*\* leke  
Dhe permbledhtas duke krahasuar faturimet e vitit 2018 me ato te vitit 2016 per keta kliente kemi nje renie te faturimeve ne shumen \*\*\* leke

Nga lista e shoqërive (kliente) që \*\*\* ka depozituar në gjykim, pala e paditur \*\*\* shpk ka arketuar shuma monetare për shërbimet e saj të matjes së shikueshmërisë nga dhe Vlerat e arkëtuara sipas viteve jepen ne monedhen Lekë ne menyre tabelare ( tabela 4 e 4 ne aktin e ekspertimit).

Po ashtu në aktin e ekspertimit jepen jepen të dhënat respektive për fondin e pages, shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shendetësore dhe numrin mesatar te punonjesve per çdo vit për të dy shoqëritë ne menyre krahasimore sipas të njejtave periudhave financiare që kanë shërbyer si referenca.

Provat bazë te vëna ne dispozicion ekspertit, siç janë renditur dhe në hyrje të Aktit të Ekspertimit janë :

Tabelë “analizë e disa klienteve me ulje të konsiderueshme të buxheteve që shkak kryesor kanë patur matjet që kryeshin nga \*\*\* “ e cila përmban të dhëna me shitjet për një grup klientesh për periudhën 2016-2018.

Librat e shitjeve respektive për periudhën 2016-2018 nga ku jane mare te dhenat analitike .

Pasqyrat financiare për vitet 2016-2018

## **Vërtetim nga DRTT për numrin e të punësuarve respektivisht për subjektet**

**Në dispozicion të ekspertit kontabël janë vënë të dhënat për listën e klientëve të paraqitur në tabelën “analizë e disa klienteve me ulje të konsiderueshme të buxheteve që shkak kryesor kanë patur matjet që kryeshin nga \*\*\* “ gjithashtu të dhëna që mund të gjenden në listën e dokumentave të pasqyruar në pergjigjen e pyetjes 1. Në dosjen gjyqësore janë depozituar faturimet (jo pagesat) kundrejt secilit klient të listës së sipërpërmendur gjithashtu edhe klientë të tjerë jashtë kësaj liste për periudhën 2016-2018 të cilët mund të gjenden në librat e shitjes të vënë në dispozicion gjykimit. Sipas aktit të ekspertimit kontabël provat e depozituara i referohen periudhës Janar 2016 deri Dhjetor 2018.**

**Sipas aktit të ekspertimit kontabël për periudhën Janar 2016 deri Dhjetor 2018 fitimet apo humbjet për klientët e listës të cilët janë vendosur në dispozicion gjenden në përgjigjen e pyetjes 4 të palës paditëse. Për periudhën jashtë këtij segmenti eksperti ka deklaruar se nuk mund të japë një përgjigje. Në lidhje me fitimet apo humbjet e shoqërisë \*\*\* sha që prej datës 11.12.2018, deri në momentin e hartimit të raportit të ekspertimit sipas aktit të ekspertimit në dosje nuk gjenden të dhëna, apo pasqyra financiare për periudhën 11.12.2018 deri në momentin e hartimit të aktit të ekspertimit nga ku mund të nxirret një konkluzion dhe ti jepet përgjigje pyetjes.**

**Në lidhje me pyetjen nëse është ekspertit të përcaktojë se cila është pjesa e fitimeve apo humbjeve të ardhura shoqërisë \*\*\* sh.a në mënyrë të menjëhershme dhe drejtpërdrejtë si rrjedhojë e aktivitetit të shoqërisë \*\*\* sh.p.k eksperti ka konkluduar se referuar të dhënave të depozituara në dosjen gjyqësore ekspertit kontabël nuk mund të përcaktojë saktësisht se sa është “masa” fitimit apo humbjes që i shkaktohet shoqërisë \*\*\* sh.a në mënyrë të menjëhershme dhe të drejtpërdrejtë si rrjedhojë e aktivitetit të shoqërisë \*\*\*. Eksperti i caktuar nga gjykata ka raportuar se për fenomenet e ndryshme të tilla si ndryshimi i konjunkturës ekonomike, rënia e cilësisë objektive të produkteve që ofron shoqëria \*\*\* sh.a, rritja e konkurrencës në treg, apo nga shoqëri të tjera që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e matjes së audiencës televizive, mund të tregohet se si ato ndikojnë në rritjen apo uljen e të ardhurave por për të llogaritur saktësisht masën e ndikimit duhen të dhëna të detajuara dhe analiza të hollësishme.**

**Nisur sa më sipër ka rezultuar se midis palës së paditur shoqëria \*\*\* dhe dëmit material të pretenduar nga pala paditëse nuk ka asnjë lidhje shkakësore. Pala paditëse ka pretenduar se si pasojë e këtyre veprime të kundraligjshme të kryera nga pala e paditur shoqëria shoqëria \*\*\*, palës paditëse i është shkaktuar një dëm i konsiderueshëm financiar dhe i është cënuar pasuria e tij në vlerën \*\*\* Euro.**

**Shkaku ligjor i kësaj padie gjyqësore ka të bëjë me dëmin pasuror që pretendohet nga pala paditëse. Nga analiza që i bëhet nenit 608 të Kodit Civil rezulton se që të ekzistojë koncepti i shpërbërimit të dëmit duhet që dëmi të jetë shkaktuar me faj, si rrjedhojë e një veprimi të paligjshëm dhe ky dëm të drejtohet interesave pasurore apo njerezore të shtetasve. Pra janë këto elemente ligjore që duhet të plotësohen në mënyrë që të ekzistojë dhe të ligjerohet dëmshpërblimi. Në rastin konkret pala paditëse nuk ka provuar shkakun që lidh dëmin e pretenduar nga paditësi me veprimet e palës së paditur, e cila me veprimet e saj të paligjshme të ketë cënuar interesat financiare të palës paditëse.**

Sic ka rezultuar nga Akti i Ekspertimit Kontabël me të dhënat e depozituara në dosjen gjyqësore nuk mund të përcaktohet saktësisht se sa është “masa” fitimit apo humbjes që i shkaktohet shoqërisë \*\*\* sh.a në mënyrë të menjëhershme dhe të drejtpërdrejtë si rrjedhoje e aktivitetit të shoqërisë \*\*\*. Gjithashtu sipas aktit të ekspertimit për fenomenet e ndryshme si psh ndryshimi i konjuktures ekonomike, rënia e cilësisë objektive të produkteve që ofron shoqëria \*\*\* sh.a, rritja e konkurrencës në treg, apo nga shoqëri të tjera që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e matjes së audiences televizive, eksperti ka konkluduar se mund të tregojë se si ato ndikojnë në rritjen apo uljen e të ardhurave por për të llogaritur saktësisht masën e ndikimit duhen të dhëna të detajuara dhe analiza të hollësishme. Pra në sintezë të përlllogaritjeve financiare nuk rezulton asnjë lidhje shkakësore midis dëmit material që pretendon pala paditëse dhe veprimeve ose mosveprimeve të palës së paditur. Gjykata krijon bindjen se lidhja shkakësore për këtë dëm jo material nuk është e vërtetuar dhe ky fakt nuk përmbush kriteret e dispozitave të mësipërme ligjore sipas nenit 608 të Kodit Civil. Pala paditëse nuk ka paraqitur provat që të provojnë faktin e ardhjes së dëmit material për paditësin nga veprimet e palës së paditur duke e cënuar pronën e palës paditëse.

Vendimi Nr.12 datë 13.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ka rregulluar të gjithë praktikën gjyqësore në lidhje me me shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor pasuror dhe jo pasuror. Ky vendim ka trajtuar në mënyrë tërësore të gjithë problematikën e dëmit pasuror dhe jo pasuror. Për këtë arsye gjykata është mbështetur kryesisht në orientimin që ka dhënë ky vendim unifikues në lidhje me konceptin e dëmit pasuror dhe jo pasuror në lidhje me dëmtimet e shëndetit.

Paditësi i është drejtuar gjykatës duke kërkuar disa kërtime juridike gjatë gjithë procesit gjyqësor dhe një nga këto kërtime ka qenë shpërblimi i dëmit të shkaktuar nga pala e paditurt në bazë të dispozitave të përgjithshme të Kodit Civil në lidhje me institutin e shkaktimit të dëmit. Parimisht padia gjyqësore përbëhet prej dy elementësh baze sic janë shkaku dhe objekti i padisë. Ndryshe nga disa legjislacione të tjera, legjislacioni ynë procedural kërkon që në padi të përcaktohet shkaku dhe objekti, pra konsiderohen elemente përbërës të padisë (nenet 154 e 185 të K.Pr.Civile).

Shkaku është arsyeja e kërimit në gjykatë, vetë shkaku ndahet në dy elemente përbërës: Në të drejtën ( bazen juridike) dhe në një gjendje fakti kundër kësaj të drejte (causa petendi). Në rastin konkret pala paditëse ka kërkuar pushim cënimi, përmbushje dëm kontraktor dhe jashtë kontraktor si dhe ka pasqyruar faktin e dëmit të ardhur nga veprime te palës së paditur duke kërkuar shpërblimet përkatëse. Objekti i padisë është ajo që kërkohet si efekt i padisë d.m.th. zbatimi i ligjit dhe realizimi i se drejtes se shkelur, p.sh. kthimi i sendit, pagimi i qirase, si rrjedhoje e zbërthimit të ligjit. Prej këtej del se objekti i padisë, duhet dalluar nga objekti material (sendi) që është objekt i së drejtës.

Kuptimi dhe dallimi i elementeve të padisë është me rëndësi të madhe teorike e dhe jurisprudenciale. Çdo padi përcaktohet dhe individualizohet, në bazë të elementëve të saj. Caktimi drejt i shkakut dhe objektit të padisë ka rëndësi sidomos për të përcaktuar llojin e marrëdhënies juridike, objekt i mosmarrveshjeje. Gjithashtu ka rëndësi për përcaktimin e drejte te rrethanave, fakteve, dokumenteve e mjeteve te tjera provuese, për gjykatën që është kompetente për ta gjykuar çështjen, për një gjykim të shpejtë dhe zgjidhje të drejtë nga gjykata. Në të kundërtën kur në padi nuk tregohet shkaku dhe

objekti edhe zgjidhja e saj do të vështirësohet.

Në të drejtën tonë procedurale është e njohur e drejta e ndryshimit të shkakut ose objektit të padisë ose edhe të dy elementeve në çdo fazë të gjykimit (neni 185 i K. Pr. Civile). Kjo arsyetohet me faktin se paditësi gjatë gjykimit ka të drejte të ndreqë gabimet e të korigjohje pasaktetit e padisë me qëllim që t'u përshtatet, marrëdhëniet juridike të palëve ndërgjyqëse. Neni 185 i K.Pr.Civile parashikon formulimin se “Paditësi gjatë hetimit gjyqësor, ka të drejte të ndryshojë shkakun ligjor të padisë. Ai pa e ndryshuar shkakun ligjor të saj, mund të shtojë, të pakesojë, ose ndryshojë objektin e padisë”. Kjo dispozitë interpretohet në mënyrën që mund të ndryshohen edhe të dy elementet e padisë. Pra shkakun mund të ndryshohet në çdo kohë, e drejtë kjo absolute e paditësit. Por paditësi pa e ndryshuar shkakun mund të ndryshojë objektin e padisë. Në interpretim gjuhësor të të dy fjalëve të dispozitës rezulton se objekti i padisë mund të ndryshohet pavarësisht nga shkakun, d.m.th. në mënyrë të pavarur, mund të ndryshosh objektin duke mbajtur të njëjtin shkak. Ndërsa shkakun në interpretim direkt të dispozitës mund të ndryshohet në çdo kohë duke mbajtur të njëjtin objekt. Fakti se po u ndryshuan të dy elementet mund të kemi një padi të re nuk sjell ndonjë problem të madh sepse kjo është e drejtë e paditësit. Në bazë të parimit të disponibilitetit kufizimi kësaj të drejte do të sillte cenim të këtij parimi. Edhe ndërgjyqësia mund të ndryshohet pa kufizim me anë të zëvendësimit të palëve. Po kështu edhe shkakun me objektin e padisë. Trajtimi si një padi të re nuk sjell shkelje, mjafton që tju komunikohen këto ndryshime palëve.

Në këndvështrim të dispozitës së mësipërme jurisprudenca gjyqësore duke pranuar parimin e disponibilitetit të paditësit në lidhje me padinë, i ka dhënë një rol aktiv edhe gjykatës në lidhje me përcaktimin e shkakut ligjor të padisë. Në Vendimin Unifikues Nr. 2, datë 29.03.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë është arsyetuar:

..... “gjykata e zbulon shkakun e padisë së paditësit duke e analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar tek dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj. Mund të ndodhë që paditësi të referojë gabimisht dispozitat ligjore, porse nga leximi i kërkesëpadisë del e qartë e drejta që ai kërkon të mbrojë. Në këtë rast gjykata duhet të zgjidhë çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar. ...

Konform këtij vendimi unifikues dhe detyruar për gjykatën, pavarësisht se çfarë rezulton në padinë e ndodhur në dosjen gjyqësore nga hetimi gjyqësor del e qartë se paditësi kërkon shpërblimin e dëmit material si dhe atë jo material pra reputacionin tregtar që i ka ardhur nga veprimet e paligjshme të palës së paditur.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka bërë të qartë në jurisprudencën e saj ndër vite se edhe personat juridikë gëzojnë të drejtën për reputacion dhe se kjo e drejtë vendoset përballë lirisë së shprehjes e mund të përbëjë një shkak legjitim për kufizimin e kësaj të fundit:

“Gjykata kujton se aspektet e lidhura me jetën private në nenin 8 të Konventës përfshijnë reputacionin e një individi... Lidhur me personat juridikë, gjykata...ka çmuar se mbrojtja e reputacionit të një kompanie mund të jetë qëllim i ligjshëm për një



**kufizim të bërë në zbatim të nenit 10, paragrafi 2, të Konventës”.**

**Në këtë kuptim, veprimet e palës së paditur duke kryer matje të shikueshmërisë për palën paditëse, duke patur ndikim të drejtpërdrejtë mbi reputacionin e kompanisë, futen në fushën e veprimit të nenit 10, paragrafi 2, të KEDNJ-së dhe mund të shqyrtohen nën dritën e mbrojtjes që kjo dispozitë ofron ndaj kompanive.**

**Sipas konceptit të dëmit nga Kodi Civil, që të ekzistojë detyrimi për shpërblimin e dëmit në rastin e cënimit të reputacionit tregtar duhet të që provohen njëkohësisht sjellja e paligjshme e të paditurve, ekzistenca e dëmit dhe lidhja shkakësore mes këtyre të dyjave. Duke qenë se paligjshmëria e dëmit lidhet me cënimin e të drejtave të personit dhe më lart u tregua se cënimi në reputacion është cënim i të drejtave themelore për të dy paditësat, më poshtë do të argumentojmë se si paditësat janë cënuar në reputacion dhe faktin se, për këtë cënim nuk ekziston asnjë justifikim i bazuar në lirinë e shprehjes.**

**Siç e kemi theksuar më sipër, aktiviteti i kryer nga pala e paditur ndaj palës paditëse pa asnjë marrëveshje paraprake midis tyre duke krijuar një listim televizionesh për shikueshmëri televizive, pasjell në cdo rast cënim të palës paditëse në lidhje me aktivitetin tregtar dhe konkretisht me reklamën televizive. Duke qenë të tilla, ato i kanë vendosur paditësat në një pozitë mjaft të vështirë tregtare dhe shoqërore, duke u lejuar partnerëve të biznesit, klientëve dhe njerëzve që nuk i njohin të krijojnë perceptime për ekzistencën e raporteve të paqëna dhe perceptime të rreme për aktivitetin dhe performancën tregtare të shoqërisë tregtare.**

**Koncepti i reputacionit është shumë i gjerë. Ai nuk lidhet me profilin publik apo me famën, por me dinjitetin njerëzor dhe, në rastin e kompanive, me reputacionin tregëtar. Kjo do të thotë se paditësat, edhe sikur të mos ishin fare të dëgjuar për publikun dhe të përmendeshin për herë të parë në këto publikime, do të gëzonin të njëjtën të drejtë për mbrojtjen e reputacionit si figurat publike apo kompanitë e njohura, për të cilat mediat shkruajnë çdo ditë.**

**Në këtë kuptim, gjykata merr në konsideratë pritshmërinë legjitime të palës paditëse për mbrojtjen e reputacionit të saj tregtar, çka përbën edhe shkakun ligjorë të ngritjes së kësaj padie.**

**Gjykata e gjen kërkimin e paditësit \*\*\* në lidhje me shumën e shpërblimit prej 500.000 Euro të pabazuar referuar akteve shkresore si dhe aktit të ekspertimit kontabël. Por nga ana tjetër në çështjen Petrina kundër Rumanisë, GJEDNJ-ja e transformoi mundësinë e ndërhyrjes së shtetit sipas nenit 10 në një detyrim të vërtetë pozitiv. Qysh prej dhënies së këtij vendimi, shteti duhet të ndërhyjë që nga momenti që janë tejkuluar parametrat që përcaktojnë kufijtë e zbatimit të nenit 10, përndryshe shteti dështon në përmbushjen e detyrimit që i takon sipas nenit 8 (e thënë ndryshe, e drejta për jetë private fillon aty ku mbaron e drejta e shprehjes). Në këtë kuptim, gjykata është e detyruar të ndërhyjë për të riparuar dëmin që i është shkaktuar paditëses nga cënimi i reputacionit të saj duke konstatuar pavërtetësinë e shkrimeve të palës së paditur mbi paditësen. Gjykata, megjithatë, çmon se ky dëm mund të riparohet me shumë më pak dëmshpërblim në para se çfarë ka kërkuar pala paditëse. Ndonëse jurisprudenca e GJEDNJ-ja ka vepruar në shumë raste vetëm me konstatimin e shkeljes së reputacionit tregtar si satisfaksion moral për të dëmtuarin, gjykata e gjen të mbështetur kërkesën e palës paditëse për shpërblim në para ndaj palës së paditur.**

Gjykata çmon se pala e paditur duhet të heqë publikimet nga faqja e saj në lidhje me palën paditëse. Kjo mund të ishte bërë edhe si pjesë e një përgënjeshtrimi të vërtetë, por gjykata çmon se duhet ta urdhërojë për të mos lejuar vazhdimin e cënimit të reputacionit tregtar të palës paditëse nga publikimi i vazhdueshëm i matjeve të paautorizuara.

Për sa i takon masës së shpërblimit në para, gjykata çmon se kjo masë duhet të jetë më e ulët se sa masa e pretenduar nga pala paditëse. Pala paditëse \*\*\* është një televion kombëtar, i njohur në publik dhe matjet e publikuara nga pala e paditur, ndonëse janë konstatuar si të paautorizuara nga gjykata, nuk janë të provuara në mënyrë të drejtpërdrejtë (shkak –pasojë) me shumën e dëmit \*\*\* Euro të kërkuar nga pala paditëse. Masa e dëmit e kërkuar nga pala paditëse nuk do të ishte proporcionale me dëmin që i është shkaktuar efektivisht asaj pasi me të dhënat e depozituara në dosjen gjyqësore eksperti kontabël nuk mund të përcaktojë saktësisht se sa është “masa” fitimit apo humbjes që i shkaktohet shoqërisë \*\*\* sh.a në mënyrë të menjëhershme dhe të drejtpërdrejtë si rrjedhojë e aktivitetit të shoqërisë \*\*\*.

Por duke qenë se aktiviteti palës së paditur e ka vendosur palën paditëse në një pozitë mjaft të vështirë tregëtare dhe shoqërore, duke u lejuar partnerëve të biznesit, klientëve dhe njerëzve që nuk i njohin të krijojnë perceptime për ekzistencën e raporteve të paqëna dhe perceptime të rreme për drejtuesit e kompanisë, gjykata krjon bindje se pala paditur duhet të dëmshpërblejë palën paditëse në shumën \*\*\* Lekë si dëm për cënimin e reputacionit tregtar.

Në llogaritjen e masës së dëmshpërblimit, gjykata çmon të bazohet në disa kritere: 1) faktin që pala paditëse është një televion kombëtar dhe për këtë arsye përtej aktivitetit tregtar ushtron një aktivitet publik me Licensë Kombëtare, 2) të dhënat e xhiros vjetore kontabile të shoqërisë palë e paditur, 3) praktikës gjyqësore shqiptare në lidhje me dëmin e reputacionit tregtar, 4) vlerën e faturimit që pala e paditur ka rënë dakord me palët e treta, 5) të dhënat e xhiros vjetore të palës paditëse, 6) mënyra e matjes së shikueshmërisë dhe periodiciteti i matjes

Lidhur me masën e sigurimit, gjykata në përputhje me argumentin ligjor sa më sipër krijon bindjen se duhet ligjëruar masa e sigurimit të padisë me anë të Vendimit datë 11.12.2018 Gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë në mënyrë që të ndalojë në cdo formë publikimin e emrit të shoqërisë \*\*\* sh. dhe \*\*\* sh.a në të dhënat të matjeve të kryera shoqëria \*\*\* Sh.p.k. Ndërsa për sa i përket pjesës tjetër të masës gjykata vendos heqjen e masës së sigurimit për ndalimin e matjeve të kryera nga pala e paditur ndaj shoqërisë \*\*\* sh.a.

Ndërsa në lidhje me pjesën e padisë për publikimin e vendimit, me shpenzimet e palës se Paditur në faqen zyrtare ëeb të Gjykatës dhe në dy gazeta me shpërndarjen më të gjerë në treg gjykata çmon se në rastin objekt gjykimi nuk plotësohen kushtet për të kryer publikeimi apo përgënjeshtime pasi aktiviteti i palës së paditur nuk ka lidhje me ndonjë qëllim apo dashje direkte të palës së paditur për të dëmtuar palën paditëse. Gjithashtu gjykata nuk sheh asnjë arsye për ta trajtuar këtë çështje gjyqësore si çështje të konkurrencës apo markave tregtare pasi palët ushtrjnë aktivitete tërësisht të ndryshme dhe nuk ka asnjë lidhje të këtyre koncepteve tregtare me çështjen objekt gjykimi.

Sa më sipër, gjykata krijoi bindjen se kërkesa padia e palës paditëse është e pjesërisht e mbështetur në ligj dhe në prova dhe si pasojë e kësaj mbështetje gjykata do të pranojë padinë pjesërisht dhe rrëzimin për pjesën tjetër tjetër të padisë në lidhje me objektin për shkaktim dëmi material dhe për publikimin e vendimit nga pala e paditur.

**PËR KETO ARSYE**

Gjykata, mbështetur në nenin 126 të Kodit të Procedurës Civile,

**VENDOSI:**

- Pranimin pjesërisht të padisë

Detyrimin e palës së paditur shoqërisë tregtare “\*\*\*\*” sh.p.k që të ndalojë matjen dhe publikimin e të dhënave të matjeveve të shikueshmërisë televizive për shoqërinë “\*\*\*\*” SH.A dhe për shoqërinë “\*\*\*\*” SH.A.

Detyrimin e të paditurit shoqëria “\*\*\*\*” Sh.p.k t’i shpërblejë palës paditëse shoqërisë “\*\*\*\*” SH.A dëmin jo pasuror të shkakuar nga cënimi i reputacionit tregtar në shumën \*\*\* lekë.

Ligjërimin e masës së sigurimit të padisë me anë të Vendimit datë 11.12.2018 të Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë.

Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të padisë.

Ky vendim perben titull ekzekutiv pasi te mare forme te prere si dhe eshte i ekzekutueshem nga permbarimi.

Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Tirane, sot më datë 21.07.2020.

Gjyqtare

Gjyqtar

Teuta HOXHA  
Julian HAXHIU

Gjyqtare

Mariana SHEGANI (DEDI)

Sekretar

Marin BUSHATI